

Profesor Dr. Ismet Elezi, mbushi 100 vjeç

Nga Dr. Xhavit Shala

Drejtor i Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë

Sot, me 5.4.2020, miku im i nderuar, Profesor Dr. Ismet Elezi, mbushi 100 vjeç. Më vjen keq që, për shkak të situatës, nuk pata mundësi t'i bëj një vizitë në shtëpi. Gjithsesi, u gëzova shumë kur dëgjova zërin e tij të kumbonte sot në telefon. I urova shëndet e jetë të gjatë në shekullin e dytë të jetës së tij.

Në këtë njëqind vjetor të Profesor Elezit, unë po përmend disa momente pikante të jetës së tij.

Prof. Dr. Ismet Elezi, ka lindur në fshatin Ftterrë (Qarku Vlorë) më 5.4.1920 nga një familje patriotike dhe e kulturuar. Babai i tij Tahsin Elezi ka qenë pjesëmarrës aktiv në Luftën e Vlorës (1920), në Organizatën "Bashkimi" dhe pjesëmarrës i lëvizjes fanoliste të Qershorit 1924.

Prof. Dr. Ismet Elezi, mësimet e para i mori në vendlindje dhe në Piqeras (Sarandë). Me ndihmën e familjes në vitin 1942 kreu Liceun e Tiranës me rezultate mjaft të larta. Po atë vit fitoi konkursin e shkoi në Firence (Itali), ku filloi studimet e larta në Fakultetin e Letërsi-Filozofisë ku mbaroi vitin e parë me rezultate maksimale (29-30), studime të cilat i ndërpreu për t'ju bashkuar Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Në korrik të vitit 1943 merr pjesë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare me rininë antifashiste të fshatit dhe në formimet e saj në Kurvelesh, Tepelenë

e Gjirokastrës, deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë. Pas çlirimit u caktua të punonte në redaksinë e gazetës "Rinia".

Në Tetor 1946 deri në Korrik 1951 kreu studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Leningradit (St. Petersburg) - Rusi, ku u diplomua jurist me diplomë të shkëlqyer. Po këtu ndoqi dhe kualifikimin pasuniversitar (1957-1960) si i pari dhe i vetmi jurist që u dërgua për të ndjekur këto studime.

Më pas mbrojti disertacionin në katedrën penale me vlerësime të larta. Për shkak të marrëdhënieve politike, mbrojtjen përfundimtare të disertacionit e bëri në Këshillin Shkencor të Universitetit të Tiranës dhe mori gradën shkencore "Kandidat i Shkencave", gradë e cila u miratua nga Komisioni i Lartë i Atestimit në Ministrinë e Arsimit (1961).

Në vitin 1972 mori titullin "Profesor" nga Komisioni i Lartë i Atestimit. Veç këtyre ka marrë më parë titullin: "Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor" në Institutin e Shkencave, titullin "Docent" në Universitetin e Tiranës.

Ka zhvilluar veprimtari pedagogjike për më shumë se 50 vjet, duke filluar në Institutin e Lartë Ekonomik (vitet 1952-1956) me leksione për bazat e Shtetit dhe të së Drejtës, e veçanërisht në Fakultetin e Drejtësisë me krijimin e tij (1957), si dhe ka dhënë leksione në Shkollën e Magjistraturës, Akademinë e Policisë, Fakultetin Juridik të Prishtinës (nga viti 1972 e pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës) etj.

Ka udhëhequr për marrjen e gradave shkencorë me dhjetëra kandidatë në Shqipëri dhe Kosovë.

Profesor Elezi ka qenë Kryetar i Komitetit Shkencor në Konferencat e Akademisë së Sigurisë si me poshtë:

1. Në Konferencën e Parë Ndërkombëtare të Akademisë së Sigurisë (A.S) me teme "Kontributi në Sigurinë Publike nëpërmjet asimimit" në Nëntor 2016.

2. Në Konferencën e II Kombëtare të AS, me teme "Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare", Prill 2018.

3. Në Konferencën e III-të Shkencore Ndërkombëtare të AS me teme "Krimi kompjuterik, kërcënimi kibernetik dhe siguria kombëtare", Nëntor 2018.

4. Në Konferencën e IV-të Ndërkombëtare të AS me teme "Siguria rrugore dhe përdoruesit e rrugës në Shqipëri", Maj 2019.

5. Në Konferencën e V-të Ndërkombëtare të AS me temë "Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare", Shkurt 2020.

6. Gjithashtu, duke filluar nga viti 2015, Prof Ismet Elezi është anëtar i bordit shkencor ndërkombëtar për botimin e Revistës Shkencore të AS "Policimi dhe siguria".

Profesor Elezi ka botuar dhe dhjetëra libra brenda e jashtë vendit.

Edhe një herë shëndet e jetë të gjatë në shekullin e dytë të jetës Tuaj i nderuar mik!